

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “A-EGLE ” SH.P.K

Ortaku i vetem i Shoqërisë, Ervin Trushilla, me atësi Bashkim dhe amësi Shpresat, dtl.17.10.1976, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, rruga “Kongresi i Manastirit” Nr.46, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar

bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, mbledhur në Tiranë sot më datë 01.07.2021

#### VENDOSI:

Të krijojë një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim të hartoja ë dhe miratojë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

#### NENI 1 *Emri*

- 1.1 Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj " A-EGLE " sh.p.k.
- 1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqerise (Ortaku i vetem).

#### NENI 2 *Forma juridike*

- 2.1 Shoqëria tregtare " A-EGLE " sh.p.k , ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).
- 2.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjeter juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetem) sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.

#### NENI 3 *Selia*

- 3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën, Rruga e "Kavajës " qëndra biznesit "Gurten " njesia bashkiake nr. 10, Tiranë.



**3.2** Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Ortaku i Vetëm).

**3.3** Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Ortaku i Vetëm) shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

**NENI 4**  
*Vula e shoqërisë*

**4.1** Shoqëria do të ketë vulën e saj.

**4.2** Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve (Ortaku i vetëm) në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**NENI 5**  
**Objekti i Veprimtarisë**

**5.1** Shoqëria ka si objekt veprimtaritë që vijojnë më poshtë:

Objekt aktiviteti i shoqërisë do të jetë çdo lloj aktivitet që do të konsiderohet i vlefshëm nga vetë politikat tregtare të shoqërisë dhe që nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi që udhëheq fushën e marrëdhënieve te tregtise se lire ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe perfshire:

Projektim dhe realizim të programeve formuese dhe të zhvillimit të burimeve njerëzore. Promovimin e aktiviteteve me karakter publicitar dhe të marrëdhënieve me publikun, organizimin e manifestimeve dhe të koferencave, përfshirë të gjitha shërbimet që kanë të bëjnë me to. Shërbime në lidhje me "Marketing Online", IT, zhvillime software, telemarketing, zhvillime strategjish marketing, aplikacion Web, reklamim fizik dhe online, etj, duke kryer çdo lloj veprimtarie nepermjet telefonit. Zhvillime dhe prezantime të statistikave të tregut dhe studimeve në lidhje me to, të kryera online nëpermjet internetit në Shqiperi dhe jashte saj. Asistencë teknike, projektim dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nëpermjet shfrytëzimit të të gjitha instrumenteve, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumenta të tjera të marketingut nëpermjet internetit. Aktivitetet këshilluese të biznesit njëherazi në marketing, publicitet, projektimin, realizimin, menaxhimin e faqeve të internetit, hapesirës publicitare, për menaxhimin dhe administrimin, krijimit të rrjeteve të shitjes, etj.

**5.2** Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjeter të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

**NENI 6**  
*Kohëzgjatja e Shoqërisë*

**6.1** Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një afat të pacaktuar.

**6.2** Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



**Neni 7**  
*Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat*

**7.1** Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i Ortakut të vetëm në vlerën 100.000 lekë.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, zoteron një kuotë me vlerë 100.000 lekë (njëqind mijë lekë), e cila përbën 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

**7.2** Kontributet që përbëjnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm.

**7.3** Financimet në formë huaje të bëra nga ortaku do të konsiderohen si hua pa interes.

**NENI 8**  
*Organet e Shoqërisë*

**8.1** Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetem).
- Administratori

**8.2** Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

**NENI 9**  
*Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut të Vetëm*

**9.1** Ortaku jep kontributin e tij në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut, në të cilën është përcaktuar në mënyrë të detajuar kontributi dhe mënyra e afatet e derdhjes së këtij kontributi në këtë shoqëri. Ortaku i Vetëm përgjigjet ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përbushja e tyre përtej afateve përkatëse. Ortaku i Vetëm mban përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

**9.2** Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakun për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tij, duhet t'i vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshire llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

**9.3** Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë Ortakun e Vetëm për periudha njëmuore dhe tremujore për ecurinë e shoqërisë, realizimin e objektivave mujore dhe tremujore, llogaritë, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare me partnerët nënkontraktorë, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

**9.4** Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka të drejtë të heqi dorë nga Shoqëria dhe mund të shesi kuotën nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes se kuotës, pa qenë nevoja e marjes së një vendimi paraprak nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë në përputhje me kushtet që i lejon



Statuti dhe Ligji. Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron atë nga detyrimet që ka deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk e cënون atë në marrjen e të ardhurave që Shoqëria ka siguruar deri në këtë moment.

**9.5** Gjatë ushtrimit të të drejtave, Ortaku i Vetëm vepron duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortaku i Vetëm respekton detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ai përpinqet për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimitarës së saj.

#### **NENI 10** *Administratori*

**10.1** Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetem). Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

**10.2** Administrator i Shoqërisë Ervin Trushilla, me atësi Bashkim dhe amësi Shpresa, dtl.17.10.1976, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, rruga “Kongresi i Manastirit” Nr.46, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me ID nr. 034017539 dhe nr. personal H61017034P.

**10.3** Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetem) mund të emërojë një administrator të dytë me vendim të saj.

#### **NENI 11** *Dispozita të fundit*

**11.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare», Kodit Civil dhe legjisacionit në fuqi.

#### **NENI 12**

**12.1** Ky Akt themelimi përpilohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe, dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES**

**ERVIN TRUSHILLA**

*ERVIN TRUSHILLA*